

KATALOG PËR KËSHILLA DHE NDIHMË PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE



Organization for Security and
Co-operation in Europe
OSCE Mission in Kosovo

KATALOG PËR KËSHILLA DHE NDIHMË PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE



Organization for Security and
Co-operation in Europe
OSCE Mission in Kosovo

PËRMBAJTE

Hyrje	1
Çfarë është dhuna në familje?	2
Kush është viktimë dhe kush kryerës i dhunës në familje?	2
Cili është qëllimi i ligjit për mbrojtje kundër dhunës në familje dhe programit kosovar kundër dhunës në familje?	3
Kush është “palë e mbrojtur”?	4
Cilat janë masat mbrojtëse dhe çfarë masash mbrojtëse ekzistojnë?	4
Cilat janë procedurat për marrjen e urdhrit për mbrojtje?	7
Cilat janë procedurat për marrjen e urdhrit për mbrojtje emergjente?	10
Cilat janë procedurat për marrjen e urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente?	13
Çfarë ndodhë nëse kryerësi shkel urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente apo urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente?	15
Si do të hetohet dhe ndiqet vepra penale që ka të bëjë me dhunën në familje?	16
Cila gjykatë e mbronë viktimën e dhunës në familje?	16
Cilat janë përgjegjësitë e policisë së kosovës ndaj viktimave të dhunës në familje?	17
Çka është strehimorja dhe çfarë shërbime ofrojnë strehimoret për viktimat?	18
Cilët hisedarë tjerë përkrahin viktimat e dhunës në familje?	19
Cili është numri telefonik i linjës ndihmëse për dhunë në familje dhe çfarë u mundëson viktimave?	21
Lista e burimeve	22

HYRJE

Ky Katalog ka për qëllim të ofrojë informacione të qarta dhe të kuptueshme për mjetet dhe burimet e ndryshme në dispozicion të viktimave të dhunës në familje në Kosovë. Ai përgjigjet në pyetjet që mund t'i kenë viktimat apo viktimat potenciale të dhunës në familje, si p.sh çfarë është urdhri mbrojtës ose kush mund ta kërkojë një të tillë. Një listë me burimet në dispozicion (linja kujdestare për ndihmë, strehimoret dhe hisedarët tjerë të rëndësishëm) për viktimat e dhunës në familje është e përfshirë gjithashtu. Informacionet e ofruara janë kryesisht të bazuara në kornizën ligjore dhe të politikave të Kosovës për dhunën në familje dhe në hulumtimin e OSBE-së të kryer në terren në tërë territorin e Kosovës.

Ky Katalog i shpërndahet institucioneve që merren me viktimat dhe viktimat potenciale të dhunës në familje (organizatat e shoqërisë civile, Policisë së Kosovës, gjykatave, zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave, strehimoreve dhe organeve komunale si njësi për të drejtat e njeriut, zyrtarëve komunalë për barazi gjinore dhe qendrave për mirëqenie sociale) për t'u përdorur si instrument për t'iu ndihmuar atyre të sigurojnë përgjigje të qarta në pyetjet që lidhen me dhunën në familje.

Katalogu e demonstroi përkushtimin e fuqishëm të OSBE-së për ta luftuar dhunën në familje dhe për t'i mbrojtur viktimat. Përmes Katalogut, OSBE-ja pret që viktimat dhe viktimat potenciale të dhunës në familje do t'i risin njohuritë e tyre për çështjet që lidhen me dhunën në familje. Saktësimi dhe hollësitë për kontaktim të hisedarëve kryesorë në nivel komunal do ta lehtësojë gjithashtu vendosjen e një rrjeti ndërmjet tyre. OSBE-ja është e bindur që viktimat dhe viktimat potenciale të dhunës në familje do të përfitojnë shumë nga një partneritet më i fuqishëm, përfshirje dhe koordinim ndërmjet të gjithë hisedarëve.

ÇFARË ËSHTË DHUNA NË FAMILJE?

Nuk ka një përkufizim universal të dhunës në familje. Në Kosovë, ajo përkufizohet si çdo veprim i qëllimshëm apo mosveprim që rezulton në keqtrajtim, kur kryhet nga një person i cili është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën, siç janë:

- **Keqtrajtimi fizik:** përdorimin e çfarëdo dhune fizike; çdo veprim që mund të shkaktojë apo kanos se do të shkaktojë dhembje fizike; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; hyrja apo largimi me dhunë i viktimës nga banesa e përbashkët apo banesa e viktimës; vënia e viktimës në pozitën që ai/ajo të frikësohet për gjendjen fizike; rrëmbimi.
- **Keqtrajtimi psikik:** përdorimi i presionit psikik; çdo veprim tjetër që mund të shkaktoj kanos se do të shkaktojë vuajtje psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së viktimës; kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes së viktimës; vënia e viktimës në pozitën që të frikësohet për gjendjen emocionale.
- **Keqtrajtimi seksual:** marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual.
- **Keqtrajtimi ekonomik:** dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë; vënia e viktimës në pozitën që të frikësohet për gjendjen ekonomike.

Dhuna në familje është, para së gjithash, një brengë nga aspekti i të drejtave të njeriut. Ajo ka rrënjë të thella në raportin e pabarabartë të pushtetit. Autoritetet kanë obligim të parandalojnë dhunën familjare, t'i mbrojnë viktimat dhe t'i ndjekin kryerësit.

KUSH ËSHTË VIKTIMË DHE KUSH KRYERËS I DHUNËS NË FAMILJE?

Viktimë e dhunës në familje është personi që vuan nga një veprim i dhunës në familje. Përkundër faktit që femrat janë më shpesh viktima të dhunës në familje, meshkujt, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara mund

gjithashtu të jenë viktimë të dhunës në familje. Dhuna në familje mund të prek këdo, pavarësisht nga gjinia, mosha, feja, identiteti gjinor, orientimi seksual, përkatësia etnike, bindja politike apo ndonjë status tjetër.

Kryerës i aktit të dhunës në familje është personi që e kryen një akt të dhunës në familje. Jo vetëm meshkujt janë kryerës të aktit të dhunës në familje; femrat gjithashtu mund të konsiderohen kryerës nëse e kryejnë në veprim të dhunës në familje.

Viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje janë të lidhur përmes marrëdhënieve familjare. **Marrëdhënia familjare** ekziston kur viktimë dhe kryerës:

- Janë ose kanë qenë të fejuar, martuar, në bashkëjetesë jashtëmartesore apo bashkëjetojnë në një shtëpi të përbashkët;
- Kanë fëmijë së bashku;
- Jetojnë në shtëpi të përbashkët dhe janë të lidhur përmes lidhjes farefisnore, martesës, adoptimit ose kujdestarisë (duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipërit dhe mbesat, motrat e vëllezërit, tezet, hallat, xhaxhallarët ose kushërinjtë);
- Janë palë në procedurë në një kontest nga marrëdhënia familjare.

CILI ËSHTË QËLLIMI I LIGJIT PËR MBROJTJE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE DHE PROGRAMIT KOSOVAR KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE?

Ligji për mbrojtje kundër dhunës në familje siguron një seri masash ligjore me qëllim të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje. Ligji i definon konceptet si dhuna në familje dhe marrëdhëniet në familje dhe sqaron se cilat janë llojet e masave dhe urdhrave mbrojtëse ekzistuese si dhe procedurat për t'i gëzuar ato.

Programi i Kosovës kundër dhunës në familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014 adresojnë çështje të rëndësishme si mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që merren me dhunën në familje, niveli i ulët i kapaciteteve për adresimin e çështjeve të dhunës në familje ndërmjet hisedarëve kryesorë, mangësitë në sistemin e referimit dhe mungesën e infrastrukturës për t'i përkrahur viktimat. Institucionet e Kosovës, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe

organizatat ndërkombëtare kanë kontribuar në mënyrë aktive në dizajnimin e këtij programi për gati një vit. Programi i ka tre objektiva:

- Të themelojë mekanizma efikase dhe gjithëpërfshirëse për parandalimin e dhunës në familje;
- Të ketë mekanizma efikase të mbrojtjes për viktimat;
- Të sigurojë shërbime efikase për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave dhe kryerësve të dhunës në familje.

Programi përfshin një mori aktivitete që duhet të zbatohen prej vitit 2011 deri në vitin 2014 në mënyrë që të arrihen objektivat. Gjithashtu, parashihet themelimi i një mekanizmi për monitorim dhe koordinim.

KUSH ËSHTË “PALË E MBROJTUR”?

Palë e mbrojtur është personi që vuan nga dhuna në familje dhe vartësit e tij/saj dhe për të cilin kërkohet urdhri mbrojtës. Urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente ose urdhri për mbrojtje emergjente të përkohshme të lëshuara nga gjykata apo policia i sigurojnë mbrojtje palës së mbrojtur.

CILAT JANË MASAT MBROJTËSE DHE ÇFARË MASASH MBROJTËSE EKZISTOJNË?

Masat mbrojtëse janë masa të lëshuara nga gjykata apo policia me qëllim të mbrojtjes së personit që i është ekspozuar dhunës duke i ndryshuar rrethanat që do të mund t’ia lejonin një kryerësi ushtrimin e akteve të mëtejshme të dhunës. Masat mbrojtëse mund t’ua kufizojnë kryerësve vizitat në shtëpitë e tyre dhe mund t’ua ndalojnë kryerësve vizitimin e fëmijëve, përveç masave tjera. Këto masa nxjerrën për kohëzgjatjen e një urdhri për mbrojtje. Me përfundimin e masave mbrojtëse, ato nuk i prekin më të drejtat pronësore apo të drejtat e kujdestarisë të kryerësit.

Gjykata komunale mund të lëshojë urdhra për mbrojtje apo urdhra për mbrojtje emergjente që përmbajnë një ose më shumë masa. Policia e Kosovës mund të lëshojë urdhra për mbrojtje të përkohshme emergjente që përmbajnë vetëm

disa prej masave mbrojtëse. Kjo trajtohet më hollësisht më poshtë.

Policia e Kosovës është përgjegjëse për të siguruar që kryerësi i respekton masat mbrojtëse.

Masat mbrojtëse që mund të lëshohen janë:

- Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial të kryerësit

Qëllimi i kësaj mase është parandalimi i sjelljeve të dhunshme nga kryerësit duke kërkuar nga ata që t'i nënshtrohen trajtimit psikosocial për t'i adresuar shkaqet që kanë sjellë deri te aktet e tyre të dhunshme. Kjo masë mund të lëshohet në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese. Masa e trajtimi psikosocial është në fuqi për aq sa është e nevojshme, por jo më shumë se 6 muaj. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet tjera relevante janë përgjegjëse për përgatitjen e masave të mëtutjeshme ligjore për zbatimin e kësaj mase.

- Masa mbrojtëse e ndalimit të afrimit viktimës

Kjo masë lëshohet për t'i mbrojtur jo vetëm viktimat por edhe vartësit e tyre dhe personat tjerë nëse është e nevojshme. Masa lëshohet kundër një personi që ka kryer dhunë në familje nëse ekziston rreziku për dhunë të mëtutjeshme. Masa duhet t'i specifikojë vendin, zonën dhe distancën brenda së cilës kryerësi nuk mund t'i afrohet viktimës.

- Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit personave të ekspozuar dhunës

Kjo masë i shqiptohet kryerësit kur ka rrezik për përsëritje të dhunës në familje. Kujdestaria e fëmijëve i besohet përkohësisht viktimës dhe të drejtat prindërore i hiqen kryerësit përkohësisht.

- Masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit

Masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, i shqiptohet personit që ka kryer dhunë ndaj anëtarit të familjes me të cilin jeton në banesë, shtëpi apo ndonjë hapësirë tjetër banimi, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje. Kryerësi obligohet menjëherë ta lëshoj banesën, shtëpinë apo hapësirën tjetër të banimit, në prani të zyrtarit policor.

- Masa mbrojtëse e shoqërimit viktimës së dhunës

Kjo masë shqiptohet me qëllim të mbrojtjes së viktimës gjatë marrjes së gjësendeve personale. Zyrtari policor është

përgjegjës për shoqërimin e viktimës në raste të tilla.

- Masa mbrojtëse e trajtimit mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotropike

Masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotropike i shqiptohet personit, i cili ka kryer dhunë në familje nën ndikimin e tyre, kur ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje. Ministria për Shëndetësi është përgjegjëse për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e kësaj mase.

- Masa mbrojtëse e marrjes së sendeve

Masa mbrojtëse e marrjes së sendit me të cilin është kryer vepra, apo sendeve me të cilat dyshohet se mund të përsëritet dhuna në familje, shqiptohet me qëllim të mbrojtjes së personit ndaj të cilit është ushtruar dhuna në familje apo e personave tjerë. Kjo masë duhet të zbatohet në pajtim me Kodin Penal të Kosovës.

- Masat për mbrojtjen e pasurisë

Gjykata, krahas masave të parapara më sipër, mund të shqiptoj edhe masat si në vijim:

- urdhërimi i kryerësit të dhunës në familje që: të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e përdorin së bashku ose ndonjë pjesë të saj; paguaj për banesë të përkohshme për viktimën ose të paguajë alimentacionin për palën e mbrojtur dhe për fëmijë (nëse kryerësi ka obligim ligjor); lejimi i kthimit në shtëpi palës së mbrojtur;
- ndalimi i kryerësit të dhunës në familje ose palës së mbrojtur, bartjen si dhe çdo lloj transaksioni të çfarëdo pasurie brenda një periudhe të caktuar kohore;
- ofrimi i mundësisë palës së mbrojtur, që vetëm ajo të posedojë dhe të shfrytëzojë pasurinë e caktuar personale të saj;
- caktimi i ndonjë mase tjetër që është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare.

Kryerësi i dhunës në familje, ka të drejtë që me shoqërimin e policisë t'i merr gjërat e tij personale.

Çfarë është urdhri për mbrojtje?

Urdhri për mbrojtje është një urdhër i lëshuar nga një gjykatë komunale ku parashihen masat mbrojtëse për viktimën për ta mbrojtur nga kryerësi i dhunës në familje. Gjykata komunale e shqyrton kërkesën për urdhër për mbrojtje dhe vendos për atë brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës.

Kush mund të kërkojë urdhër për mbrojtje?

Kërkesa për urdhër për mbrojtje mund të parashtrohet nga:

- pala e mbrojtur;
- përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;
- mbrojtësi i viktimave (me pëlqimin e palës së mbrojtur);
- përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur e ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri;
- OJQ-të, që janë njoftuar me problemin e viktimës

Cila duhet të jetë forma dhe përmbajtja e kërkesës për urdhër për mbrojtje?

Kërkesa për urdhër për mbrojtje mund të paraqitet me shkrim ose gojarisht. Kërkesa duhet të përfshijë:

- Emrin e gjykatës;
- Emrin, adresën dhe profesionin e kryerësit;
- Emrin dhe adresën e palës së mbrojtur dhe të personit i cili e ka paraqitur kërkesën, dhe lidhjen e tyre me kryerësin; nëse zbulimi i adresës e vë në rrezik palën e mbrojtur apo parashtruesin e kërkesës, do të sigurohet një adresë alternative ose të dhënat ku është shënuar adresa do të mbahen konfidenciale;
- Përshkrim i hollësishëm i ngjarjeve lidhur aktet e dhunës në familje. Nëse është e mundur, duhet të bashkëngjiten dëshmitë;
- Arsyeja pse nevojitet urdhër mbrojtje;
- Masat e propozuara të mbrojtjes.

Kush e shqyrton dhe e nxjerr vendimin për kërkesën për urdhër për mbrojtje?

Gjykata komunale e shqyrton kërkesën për urdhër për mbrojtje dhe vendos brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës. Vendimi për të pranuar ose refuzuar një kërkesë për urdhër për mbrojtje duhet të përmbajë arsyetim të plotë. Vendimi për aprovimin e një urdhri për mbrojtje duhet të bëjë lidhjen e fakteve të rastit me masat specifike mbrojtëse të urdhëruara.

Para se të vendos, gjykata mbanë seancë dëgjimore me personat si në vijim:

- palën e mbrojtur, përfaqësuesin e autorizuar ose mbrojtësin e viktimave;
- kryerësin e dhunës ose përfaqësuesin e tij të autorizuar;
- parashtruesin e kërkesës;
- dëshmitarët të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm;
- përfaqësuesin nga qendra për punë sociale të komunës në të cilin jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur më poshtë në rastin kur:
 - parashtruesi i kërkesës është i moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare ose i mungon zotësia e veprimit; ose;
 - veprat e supozuara të dhunës në familje kanë ndikim në personin i cili është i moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose nuk ka zotësi të veprimit.

Dëgjimi dhe shqiptimi mbahet në mungesë të kryerësit të dhunës në familje nëse kryerësi i dhunës në familje është thirrur në mënyrë të rregullt dhe nëse kërkesa është mbështetur në dëshmi të mjaftueshme .

Kërkesa konsiderohet si e tërhequr nëse në seancën e dëgjimit nuk paraqiten as pala e mbrojtur e as përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur dhe nëse këta individë janë thirrur në mënyrë të rregullt, ndërsa nuk e kanë njoftuar gjykatën për arsyet e mungesës së tyre. Tërheqja e kërkesës nuk parandalon paraqitjen e kërkesës tjetër.

Kush e shqipton urdhrin për mbrojtje?

Gjykata komunale e shqipton urdhër për mbrojtjen, në rastet kur dyshon se kryerësi i dhunës pashmangshëm rrezikon sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur dhe personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrit mbrojtjes.

Çfarë përmbajtje dhe kohëzgjatje ka një urdhër për mbrojtje?

Në urdhrin për mbrojtje duhet të ceket:

- masa mbrojtëse e caktuar nga gjykata;
- njoftimi se moszbatimi i urdhrit mbrojtës përbënë vepër penale;
- njoftimi për të drejtën e ankesës dhe për faktin se kryerësit të dhunës mund t'i ofroj ndihmë përfaqësuesi i autorizuar.

Kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje nuk mund të jetë më e gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj, por me mundësi vazhdimi jo më shumë se njëzetekatër (24) muaj.

Kur hyn në fuqi urdhri për mbrojtje?

Urdhri mbrojtës hyn në fuqi menjëherë dhe ekzekutohet pa vonesë. Urdhri i dërgohet kryerësit të dhunës në familje Policisë së Kosovës, qendrave për punë sociale, si dhe palëve të tjera në procedurë.

Pas skadimit të urdhrit mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes emergjente, pushojnë të gjitha kufizimet e shqiptuara.

A mund të parashtrohet ankesë kundër urdhrit për mbrojtje?

Kundër vendimit të urdhrit për mbrojtje mund të ushtrohet ankesë brenda afatit tetë (8) ditë nga dita e dorëzimit të vendimit. Parashtrimi i ankesës nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit mbrojtës.

A mund të ndryshohet apo ndërpritet urdhri për mbrojtje?

Kur rrethanat kanë ndryshuar, pala e mbrojtur ose kryesi i dhunës mund t'i parashtrojë kërkesë gjykatës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit për mbrojtje. Parashtrësia nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit nga Policia. Gjykata mund të vendosë që urdhri për mbrojtje:

- të mbetet në fuqi;
- të ndryshohet;
- të ndërpritet, nëse gjykata vlerëson se kanë pushuar të gjitha shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar urdhri mbrojtës.

A mund të vazhdohet urdhri për mbrojtje?

Pesëmbëdhjetë ditë para skadimit të urdhrit për mbrojtje, pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar mund të parashtrojë kërkesë për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje. Gjykata mund të vendosë që:

- të ndërpres urdhrin për mbrojtje në datën e skadimit të tij; ose;
- të vendosë që të vazhdohet urdhri për mbrojtje.

Nëse nuk parashtrohet kërkesa për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje, ai ndërpritet menjëherë në ditën e skadimit.

CILAT JANË PROCEDURAT PËR MARRJEN E URDHËRIT PËR MBROJTJE EMERGJENTE?

Çfarë është urdhri për mbrojtje emergjente?

Urdhri për mbrojtje emergjente është urdhër i lëshuar përkohësisht nga gjykata komunale me të cilin synohet mbrojtja e viktimës nga keqtrajtuesi i saj/tij. Gjykata komunale e shqyrton kërkesën për urdhër për mbrojtje emergjente dhe vendos për të brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës.

Kush mund të kërkojë urdhër për mbrojtje emergjente?

Kërkesa për urdhër për mbrojtje mund parashtrohet nga:

- Viktima;
- Përfaqësuesi i autorizuar i viktimës;
- Mbrojtësi i viktimës (me pëlqim të viktimës);
- Personi me të cilin viktima ka marrëdhënie familjare;
- Përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur ka vendbanim apo vendqëndrim, në rast se viktima është e mitur;
- Personi i cili ka njohuri të drejtpërdrejta për aktin apo aktet e dhunës në familje ndaj viktimës;
- OJQ-ja që është e njoftuar me gjendjen e viktimës.

Çfarë formulari dhe përmbajtje duhet të ketë kërkesa për urdhër për mbrojtje emergjente?

Kërkesa për urdhër për mbrojtje emergjente mund të paraqitet me shkrim ose gojarisht në gjykatën komunale. Kërkesa duhet të përfshijë:

- Emërtimin e gjykatës;
- Emrin, adresën dhe profesionin e kryerësit të dhunës në familje;
- Emrin dhe adresën e viktimës dhe të personit i cili ka paraqitur kërkesën për mbrojtje dhe lidhjen familjare me kryerësin; nëse zbulimi i adresës paraqet rrezik për palën e mbrojtur apo kërkuuesin, atëherë sigurohet një adresë alternative ose dosjet në të cilat shkruhet adresa mbahen të mbyllura;
- Përshkrimin në hollësi të ngjarjes në lidhje me aktet e dhunës në familje; nëse është e mundshme, duhet t'i bashkëngjiten provat;
- Arsytet për një urdhër për mbrojtje;
- Masat mbrojtëse të propozuara.

Kush e shqyrton dhe vendos për kërkesën për urdhër për mbrojtje emergjente?

Gjykata komunale shqyrton kërkesën për urdhër për mbrojtje emergjente dhe vendos brenda 24 orëve pas paraqitjes së kërkesës. Vendimi për miratimin apo refuzimin e kërkesës për urdhër për mbrojtje emergjente duhet të jetë plotësisht i arsyetuar. Vendimi me anë të së cilit miratohet urdhri për mbrojtje emergjente duhet të lidhë faktet e rastit me masat e veçanta të mbrojtjes që shqiptohen.

Para se të vendosë, gjykata do të mbajë një seancë dëgjimi për t'i dëgjuar personat e mëposhtëm:

- Palën e mbrojtur, përfaqësuesin e autorizuar ose mbrojtësin e viktimave;
- Kryerësin e dhunës ose përfaqësuesin e autorizuar;
- Parashtruesin e kërkesës;
- Dëshmitarët të cilët janë të njoftuar për rastin e dhunës në familje.

Nëse është e nevojshme, gjykata mund të mbajë një seancë dëgjimi dhe të shqiptojë një urdhër për mbrojtje emergjente në mungesë të kryerësit.

Kush shqipton urdhrin për mbrojtje emergjente?

Gjykata komunale shqipton urdhrin për mbrojtje emergjente nëse dyshon se kryerësi pashmangshëm rrezikon shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e palës së mbrojtur dhe të personit me të cilin viktimë ka lidhje familjare dhe i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrit.

Kur hyn në fuqi urdhri për mbrojtje emergjente?

Urdhri për mbrojtje emergjente hyn në fuqi menjëherë dhe ekzekutohet pa vonesë. Urdhri i dërgohet menjëherë kryerësit, policisë së Kosovës, qendrave për punë sociale, si dhe palëve tjera në procedurë.

Pas skadimit të urdhrit, pushojnë të gjitha kufizimet e shqiptuara.

Cila është përmbajtja dhe kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje emergjente?

Urdhri për mbrojtje përfshinë:

- Masat mbrojtëse të caktuara nga gjykata;
- Njoftimin se moszbatimi i urdhrit mbrojtës përbën një vepër penale;
- Njoftimin për të drejtën e ankesës dhe se përfaqësuesi i autorizuar mund t'i ofrojë ndihmë kryerësit;
- Datën e dëgjimit për konfirmimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, e cila mbahet brenda tetë ditëve prej shqiptimit të urdhrit për mbrojtje emergjente.

Urdhri për mbrojtje emergjente skadon në fund të dëgjimit për konfirmimin e urdhrit për mbrojtje emergjente. Në këtë dëgjim, gjykata do të urdhërojë përfundimin e urdhrit për mbrojtje emergjente ose do të shqiptojë një urdhër për mbrojtje.

A mund të parashtrohet ankesë kundër urdhrit për mbrojtje emergjente?

Kundër vendimit për urdhër për mbrojtje emergjente mund të parashtrohet ankesë brenda tri ditëve nga dita e shqiptimit të vendimit. Parashtrimi i ankesës nuk e ndalon policinë që ta ekzekutojë urdhrin për mbrojtje emergjente.

A mund të ndryshohet apo ndërpritet urdhri për mbrojtje emergjente?

Pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga kryerësi apo personi i autorizuar, gjykata mund të vendosë që ta konfirmojë, ndryshojë apo ndërpresë urdhrin për mbrojtje emergjente.

A mund të vazhdohet urdhri për mbrojtje emergjente?

Pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar apo mbrojtësi i viktimës mund të paraqesin një kërkesë për urdhër për mbrojtje emergjente dy ditë para skadimit të tij. Më pas, gjykata vendos për:

- Vazhdimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, nëse vazhdojnë të ekzistojnë kërcënimet, mbi bazën e të cilave është shqiptuar urdhri për mbrojtje emergjente;
- Ndërprerjen e urdhrit për mbrojtje emergjente në ditën e skadimit të tij.

Nëse nuk paraqitet asnjë kërkesë për vazhdim, atëherë urdhri do të përfundojë në datën e skadimit.

CILAT JANË PROCEDURAT PËR MARRJEN E URDHRI PËR MBROJTJE TË PÛRKOHSHME EMERGJENTE?

Çka është urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente?

Urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente është një urdhër i shqiptuar nga policia e Kosovës jashtë orarit të punës së gjykatës komunale, i cili siguron masat mbrojtëse për viktimën kundrejt kryerësit.

Kush mund të parashtrojë kërkesë për urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente?

Kërkesa për urdhrin për mbrojtjen e përkohshme emergjente mund të parashtrohet nga:

- Viktima;
- Përfaqësuesi i autorizuar apo mbrojtësi i viktimës;
- personi me të cilin viktima ka një marrëdhënie familjare;
- përfaqësuesi i qendrës për punë sociale i komunës ku pala e mbrojtur ka vendbanim apo vendqëndrim;
- personi i cili ka njohuri të drejtpërdrejta për aktin apo aktet e dhunës në familje ndaj viktimës;
- OJQ-ja që është e njoftuar me gjendjen e viktimës së dhunës në familje.

Kush e shqipton urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente dhe mbi çfarë baze?

Shefi i njësitit rajonal të policisë së Kosovës kundër dhunës në familje mund të shqiptojë urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente nëse ekzistojnë arsye për të besuar se:

- Kryerësi ka kryer apo është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje;
- Kryerësi paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë apo të atypëratyshëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
- Shqiptimi i urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare.

Kur hyn në fuqi urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente?

Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente hyn në fuqi menjëherë pas shqiptimit të tij nga policia e Kosovës. Urdhri i dërgohet menjëherë kryerësit dhe fillon të zbatohet ndaj kryerësit pasi t'i jetë dorëzuar atij/asaj personalisht.

Një kopje e urdhrit i dërgohet palës së mbrojtur dhe personave të tjerë të shënuar në urdhër, parashtruesit të kërkesës, stacionit lokal të policisë dhe qendrës për punë sociale në komunën ku ka vendbanim apo vendqëndrim pala e mbrojtur dhe personat e tjerë të shënuar në urdhër, gjykatës kompetente komunale dhe mbrojtësit të viktimës.

Cilat masa mbrojtëse policia e Kosovës mund të përfshijë në një urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente?

Policia e Kosovës mund të përfshijë njërën apo disa prej masave mbrojtëse në një urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente:

- Ndalimin e afrimit të viktimës;
- Ndalimin e shqetësimit të viktimës;
- Largimin nga banesa, shtëpia apo ndonjë hapësirë tjetër;
- Konfiskimin e pronës.

Për një përshkrim të mëtejshëm të këtyre masave, ju lutem shikoni pjesën e lartcekur të titulluar “Çka janë masat mbrojtëse dhe çfarë masa mbrojtëse ekzistojnë?”

Cila është përmbajtja dhe kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente?

Një urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente duhet të theksojë:

- Masat mbrojtëse të shqiptuara nga policia e Kosovës;

- Kohëzgjatjen e urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente, e cila skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë së cilës punon gjykata;
- Vërejtjen se shkelja e urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente është vepër penale;
- Njoftimin se përfaqësuesi ligjor mund t'i ofrojë ndihmë kryerësit të dhunës;
- Shpjegimin se pas kalimit të afatit të urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente, pala e mbrojtur mund të paraqesë kërkesë për urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente ose urdhër për mbrojtje, kundër së cilës mund të ushtrohet ankesë;
- Urdhri për mbrojtje të përkohshme skadon në fund të ditës vijuese gjatë së cilës punon gjykata.

ÇFARË NDODHË NËSE KRYERËSI SHKEL URDHRIN PËR MBROJTJE, URDHRIN PËR MBROJTJE EMERGJENTE APO URDHRIN PËR MBROJTJE TË PËRKOHSHE EMERGJENTE?

Shkelja e urdhrit për mbrojtje ose urdhrit për mbrojtje emergjente apo e urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente është *vepër penale*. Personi i cili shkel ndonjërin prej këtyre urdhrave dënohet me gjobë prej 200 deri në 2000 euro, ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Shkelja e urdhrit për mbrojtje, e urdhrit për mbrojtje emergjente apo e urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente do të ndiqet menjëherë.

Përsëritja e vazhdueshme e shkeljes në tërësi ose pjesërisht e ndonjërit prej këtyre urdhrave konsiderohet rrethanë rënduese për kryerësin.

SI DO TË HETOHET DHE NDIQET VEPRA PENALE QË KA TË BËJË ME DHUNËN NË FAMILJE?

Nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer vepër penale që ka të bëjë me dhunën në familje, policia do të arrestojë kryerësin në përputhje me ligjin. Nëse kryerësi i dyshuar nuk është arrestuar apo nëse vendndodhja e kryerësit nuk dihet, policia duhet t'i sigurojë rregullisht viktimës apo përfaqësuesit ligjor të viktimës një përditësim mbi gjendjen e hetimeve, duke përfshirë informatat lidhur me vendndodhjen e kryerësit të dyshuar ose për lirim të tij apo saj nga paraburgimi.

Shqiptimi i urdhrit për mbrojtje, urdhrit për mbrojtje emergjente apo urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente nuk ndalon viktimën të nisë procedurën penale për sa i përket veprimeve ose mosveprimeve që përbëjnë vepra penale.

CILA GJYKATË E MBRONË VIKTIMËN E DHUNËS NË FAMILJE?

Gjykata kompetente për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje është gjykata komunale që ka kompetenca në komunën ku parashtuesi i kërkesës ka vendbanim apo vendqëndrim. Kjo gjykatë komunale është përgjegjëse për shqiptimin e masave mbrojtëse, kur një gjë e tillë është e nevojshme.

Me kërkesë të gjykatës komunale gjegjëse, çdo gjykatë tjetër komunale që ka juridiksion në komunën ku pala e mbrojtur ka ndërruar vendbanim (ose nëse ndërrimi i shërben interesit më të mirë të palës së mbrojtur) mund gjithashtu të shqyrtojë apo të shqiptojë masat mbrojtëse.

Në rastet kur një kërkesë e mëparshme i është paraqitur gjykatës kompetente në pajtim me Ligjin për familjen të Kosovës, atëherë e njëjta gjykatë është përgjegjëse për shqyrtimin dhe shqiptimin e masave mbrojtëse kur një gjë e tillë është e nevojshme.

CILAT JANË PËRGJEGJËSITË E POLICISË SË KOSOVËS NDAJ VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE?

Policia e Kosovës është përgjegjëse që t'i përgjigjet secilit njoftim për vepër apo kërcënim të kryerjes së akteve të dhunës në familje, ose shkeljes së një urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente ose një urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente, pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin. Policia e Kosovës përpilon një raport pa marrë parasysh se a është kryer vepra apo jo, a është ndaluar dikush apo jo, si dhe një kopje të raportit ia jep viktimës apo përfaqësuesit ligjor.

Përveç shqiptimit të urdhrave për mbrojtje të përkohshme emergjente, Policia e Kosovës është përgjegjëse për përdorimin e mjeteve të arsyeshme për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje dhe për të parandaluar dhunën e mëtutjeshme, duke:

- Krijuar një linjë të posaçme telefonike për raportim të dhunës në familje;
- Ia siguruar viktimës apo përfaqësuesit ligjor të viktimës kontaktin zyrtar me nëpunësin hetues të policisë nëse viktimat ka nevojë për ndihmë të mëtejshme; në rast se mungon nëpunësi hetues, atëherë ndonjë nëpunës tjetër i policisë do ta ndihmojë viktimën;
- Informuar viktimën, përfaqësuesin ligjor ose mbrojtësin e viktimës për të drejtat e viktimës në përputhje me ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente;
- Informuar viktimën lidhur me shërbimet e ndihmës ligjore, psikologjike dhe ndihmës tjetër në dispozicion nga institucionet qeveritare si dhe prej rrjetit të autorizuar të OJQ-ve;
- Informuar ofruesit gjegjës të shërbimeve lidhur me ndonjë rast të dhunës në familje dhe mundësimin e kontaktit me viktimën me kërkesë të viktimës;
- Siguruar transportin për viktimën dhe, nëse është e nevojshme, të varësve të saj deri në:
 - Objektin e duhur mjekësor për trajtim dhe kontroll mjekësor;
 - Vendstrehim apo vendqëndrim tjetër të sigurt dhe të përshtatshëm, me kërkesën e viktimës;
- Siguruar mbrojtjen për personin i cili ka lajmëruar incidentin, nëse paraqitet nevoja, dhe në përputhje me obligimet gjegjëse ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve;

- Larguar kryerësin nga banesa ku e ka vendbanimin apo vendqëndrimin viktima apo ndonjë pjesë të saj (në lidhje me masat mbrojtëse të largimit nga banesa, shtëpia apo ndonjë hapësire tjetër banimi).

Përveç kësaj, policia duhet ta raportojë rastin menjëherë në qendrën e punës sociale të komunës ku ai person ka vendbanim apo vendqëndrim në rast se:

- Viktima është e moshës nën 18 vjet ose kur personi nuk ka zotësi veprimi;
- Aktet e dhunës në familje janë aq të rënda sa ndikojnë në sigurinë a qetësinë e personit të moshës nën 18 vjet, ose nuk ka aftësi të plotë të veprimit dhe jeton në banesën e njëjtë me kryerësin.

-

ÇKA ËSHTË STREHIMORJA DHE ÇFARË SHËRBIME OFROJNË STREHIMORET PËR VIKTIMAT?

Strehimorja është një vend i sigurt ku viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre mund të qëndrojnë përkohësisht dhe ato ofrojnë mbrojtje dhe shërbime tjera. Aktualisht, ekzistojnë strehimore në Gjakovë/Đakovica, Gjiilan/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština dhe Prizren që strehojnë viktimat të komuniteteve nga e tërë Kosova.

Viktimat mund të qëndrojnë gjashtë muaj në strehimore. Kjo periudhë mund të vazhdohet në marrëveshje me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Strehimoret zakonisht iu sigurojnë viktimave strehim, ushqim, veshmbathje, këshilla (psiko-sociale dhe ligjore), mbështetje mjekësore, aftësim profesional (gjuhë, kompjuter, internet, shkrim dhe lexim, qepje, gatim, rregullim flokësh, rrobaqepësi), arsim shëndetësor, shërbime për kërkim të punës dhe veprimtari për fëmijët (muzikë, vizatim, kërcim) ndër të tjera. Strehimoret patrollohen nga policia dhe kanë aranzhime të ndryshme të sigurisë.

Disa strehimore gjithashtu kontribuojnë në parandalimin e dhunës në familje, duke organizuar veprimtari për vetëdijësim dhe vizita sensibilizuese në vendet rurale. Disa strehimore janë gjithashtu të përfshira në monitorim dhe promovim të një kornize ligjore dhe të politikave në Kosovë, e cila është e financuar në mënyrë të mirëfilltë dhe e cila ofron mbrojtje për viktimat e dhunës në familje. Disa të tjera kryejnë vizita të rregullta te viktimat, pra pasi që ato kthehen në familje apo bëhen të pavarura.

Strehimoret drejtohen nga OJQ-të në marrëveshje me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në raste të rralla, komunat mbulojnë disa shpenzime.

CILËT HISEDARË TJERË PËRKRAHIN VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE?

Zyrtarët mbrojtës të viktimës (ZMV)

Mbrojtësi i viktimës është personi i autorizuar për mbrojtjen e interesave të viktimave të dhunës në familje dhe për ofrimin e mbështetjes dhe ndihmës ndaj viktimave. Për më shumë informata për rolin e ZMV, ju lutem referohuni përshkrimit të lartcekur për llojet e ndryshme të urdhrave për mbrojtje.

Zyrat rajonale për ndihmë juridike

Zyrat rajonale për ndihmë juridike ofrojnë ndihmë juridike falas për viktimat të cilat gëzojnë të drejtën për këtë lloj ndihme. Ato mundësojnë qasjen e viktimave në drejtësi, për shembull, duke i dhënë informata dhe këshilla viktimave për të drejtat e tyre ligjore, duke përfaqësuar viktimat para gjykatave ose organeve administrative, si dhe duke ndihmuar në hartimin e procedurave dhe dokumenteve ligjore.

Qendrat për punë sociale (QPS)

QPS luajnë një rol kyç në mbështetjen e viktimave të dhunës në familje në lidhje me gjykatat dhe policinë, posaçërisht kur viktimat janë të mitur ose përndryshe nuk kanë zotësinë e veprimit. Përveç kësaj, QPS vlerëson gjendjen e viktimave të dhunës në familje dhe ndihmon për të gjetur zgjidhjen më të mirë për viktimën. QPS mund po ashtu të kryejë vizita në shtëpi dhe mund të ndërlidhet me spitalet dhe shtëpitë e sigurta. QPS mund të ofrojë këshilla psiko-sociale dhe ligjore për viktimat. QPS gjithashtu mund të përfshijë një viktimë në skemën e ndihmës sociale (nëse viktima gëzon këtë të drejtë). Për më shumë informata për rolin e QPS, ju lutem referohuni përshkrimit të lartcekur për llojet e ndryshme të urdhrave për mbrojtje.

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)

IAP është një institucion i pavarur që ka për mandat adresimin e shkeljeve të pretenduara të drejtave të njeriut nga institucionet publike në Kosovë. IAP kryen hetime, nxjerr raporte dhe ofron shërbime juridike dhe avokim publik. IAP ofron shërbime falas dhe pranon ankesat nga kushdo në Kosovë. IAP mund të luajë një rol kyç në mbështetjen e viktimave të dhunës në familje, duke adresuar mangësitë përkitazi me zbatimin e ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje që prekë të drejtat e viktimave të dhunës në familje.

Agjencia për barazi gjinore (ABGJ)

ABGJ u themelua në kuadër të zyrës së kryeministrit si një organ i ndarë që duhet të promovojë, hartojë, këshillojë dhe monitorojë zbatimin e ligjeve dhe politikave të ndërlidhura me barazinë gjinore në Kosovë. Ndër shumë veprimtari në fushën e dhunës në familje, ABGJ së bashku me ministritë gjegjëse dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile ishte një prej aktorëve kryesor për krijimin e Programit të Kosovës kundër dhunës në familje dhe Planit të veprimit 2011-2014.

Komisioni për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione (Komisioni)

Ky komision është një prej komisioneve funksionale të Kuvendit të Kosovës. Përveç që ka rol në formulimin e projektligjeve lidhur me mandatin e tij, Komisioni është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtyre ligjeve. Komisioni kontribuon në luftimin e dhunës në familje nëpërmjet monitorimit të zbatimit të ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe të ligjit për barazi gjinore.

Njësitë komunale për të drejtat e njeriut (NJKDNJ) dhe zyrtarët komunalë për barazi gjinore (ZKBGJ)

NJKDNJ janë mekanizma përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel komunal dhe në përputhje me ligjet, politikat dhe standardet ndërkombëtare. Si detyrë kryesore, ZKBGJ-të e kanë drejtimin e programeve komunale që kanë të bëjnë me barazinë gjinore për zbatimin e ligjit për barazi gjinore dhe standardeve tjera për të drejtat e njeriut. NJKDNJ dhe ZKBGJ mund të kontribuojnë në parandalimin e dhunës në familje, gjegjësisht nëpërmjet veprimtarive për ngritjen e vetëdijesimit dhe rrjetëzimit me hisedarët e tjerë kyç me qëllim të mbrojtjes më të mirë të viktimave të dhunës në familje.

Organizatat joqeveritare (OJQ), grupet punuese komunale dhe grupet tjera punuese

OJQ-të, grupet punuese komunale dhe grupet tjera punuese kanë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e viktimave të

dhunës në familje. GPK-të dhe grupet tjera punuese zakonisht përbëhen nga hisedarë në nivel komunal, të cilët përfaqësojnë institucionet publike dhe shoqërinë civile. Referohuni tabelave të mëposhtme për një përshkrim të veprimtarive që ndërmerren nga OJQ-të, GPK-të dhe grupet tjera në fushën e dhunës në familje. Kjo listë është bazuar në kërkimet fushore të OSBE-së dhe nuk është shteruese. Përveç kësaj, OJQ-të që janë të njoftuara me rastin e viktimës mund të parashtrojnë një kërkesë për urdhër për mbrojtje, urdhër për mbrojtje emergjente dhe urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente.

Spitalet dhe shkollat

Spitalet dhe shkollat janë hisedarë të rëndësishëm në fushën e dhunës në familje. Në këto vende mund të identifikohen viktimat e dhunës në familje dhe prej aty viktimat mund t'iu referohen agjencive tjera, si policisë, gjykatave apo strehimoreve. Ato duhet të përfshihen në të gjitha forumet që merren me çështjet e dhunës në familje.

CILI ËSHTË NUMRI TELEFONIK I LINJËS NDIHMËSE PËR DHUNË NË FAMILJE DHE ÇFARË U MUNDËSON VIKTIMAVE?

Numri falas i linjës ndihmëse është 0800 11112.

Linja telefonike ndihmëse për dhunë në familje dhe kundër trafikimit në Kosovë mundëson identifikimin e viktimave të dhunës në familje dhe të trafikimit me qenie njerëzore, si dhe referimin e tyre në institucionet e duhura. Linja funksionon nën zyrën për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave pranë zyrës së kryeprokurorit publik të Kosovës. Linja ndihmëse ofron:

- Ndihmë për viktimat e dhunës në familje ose të trafikimit, duke i dhënë atyre informatat e domosdoshme dhe numrat kontaktues;
- Informata mbi dhunën në familje dhe trafikimin me qenie njerëzore për palët e ndryshme (viktimat dhe viktimat e mundshme, masmedian, institucionet, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të, qytetarët);
- Një mundësi për qytetarët dhe viktimat që të lajmërojnë krimet e ndërlidhura me dhunën në familje dhe trafikimin me qenie njerëzore.

LISTA E BURIMEVE

LEGJENDA E NGJYRAVE DHE E SHKURTESAVE

INSTITUCIONET PUBLIKE	
	Njësiti rajonal i Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje
QPS	Qendra për Punë Sociale
NJKDNJ	Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut
ZKBGJ	Zyrtar Komunal për Barazi Gjinore
ZMV	Zyrtar për Mbrojtjen e Viktimave

STREHIMORJA

IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
-----	-------------------------------------

OJQ / GPK / TASK FORCA	
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
GPK	Grup Punues Komunal
	Task forcë

Komuna e Deçanit/Deçane	244
Komuna e Dragashit/Dragaš	25
Komuna e Ferizajit/Uroševac	26
Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje	27
Komuna e Gjakovës/ Đakovica	28
Komuna e Gjilanit/Gnjilane	29
Komuna e Glogocit/Glogovac	30
Komuna e Gračanica/Gračanicës	31
Komuna e Hanit të Elezit/Đeneral Janković	32
Komuna e Istogut/Istok	32
Komuna e Junikut	33
Komuna e Kaçanikut/Kaçanik	34
Komuna e Kamenicës/Kamenica	35
Komuna e Klinës/Klina	35
Komuna e Klokot-Vrbovac/Kllokotit-Vërbocit	36
Komuna e Leposavić/Leposaviqit	37
Komuna e Lipjanit/Lipljan	37
Komuna e Malishevës/Mališevo	38
Komuna e Mamuşa/Mamushës/Mamuşa	38
Komuna e Mitrovicës/Mitrovica	39
Komuna e Novo Brdo/Novobërdës	40
Komuna e Obiliqit/Obilić	41
Komuna e Parteş/Parteshit	42
Komuna e Pejës/Peć	42
Komuna e Podujevës/Podujevo	44
Komuna e Prishtinës/Priştina	45
Komuna e Prizrenit	47
Komuna e Ranilug/Ranillugut	49
Komuna e Rahovecit/Orahovac	50
Komuna e Štrpcë/Shtërpçës	51
Komuna e Shtimes/Štimlje	51
Komuna e Skenderajt/Srbica	52
Komuna e Suharekës/Suva Reka	52
Komuna e Vitisë/Vitina	53
Komuna e Vushtrrisë/Vučitrn	54
Komuna e Zubin Potok/ Zubin Potokut	54
Komuna e Zvečan/Zveçanit	55

KOMUNA E DEÇANIT / DEÇANE

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI
Njësi rajonal i Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje	Drejtoria rajonale e Policisë së Kosovës në Pejë/Peć, rr. "Mbretëresha Teutë"	nuk është në dispozicion	92 (fiks) 192 (mobil)
Qendra për punë sociale	Rr. UÇK	nuk është në dispozicion	0390361014
ZKBGJ dhe NJKDNJ	Pallati i kulturës, kati i II-të	nuk është në dispozicion	0390361100
Zyrtari për mbrojtjen e viktimave	Objekti i Gjykatës Komunale, rr. "Sali Qeku"	vaau_advocates@yahoo.com	044425469

STREHIMORJA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI
Kryesisht mbulohet nga strehimorja në Gjakovë/Đakovica	linjajuaj@hotmail.com	0390330098

IAP	ADRESA	TELEFONI
Mbulohet nga zyra në terren e Pejës/Peć	Ndërtesa e komunës, rr. "Mbretëresha Teutë", nr. 59	039432931

OJQ-të	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI	QËLLIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Shoqata e grave "Jeta"	Pallati i kulturës "Jusuf Gërvalla", rr. "Skënderbeu"	ojqjeta@hotmail.com ojqjeta@yahoo.com	039061375	Vetëdijesimi për të drejtat e grave dhe fuqizimi i rolit të tyre në shoqëri	Gratë, të moshuarit dhe viktimat e mundshme të dhunës në familje	- Vetëdijesim për të drejtat e grave - Shëndetësi dhe arsimit - Kurse floktarie, rrobaqepësie dhe thurjeje me shtiza
Nderi	Qendra për Punë Sociale, rr. "UÇK"	nuk është në dispozicion	049452691	Vetëdijesimi për të drejtat e grave dhe fuqizimi i rolit të tyre në shoqëri	Gratë	- Vetëdijesim për të drejtat e grave
Shoqata e Intelektualëve të Pavarur (SHIP/UNI)	Pallati i kulturës "Jusuf Gërvalla", rr. "Skënderbeu"	nuk është në dispozicion	044182689	Promovimi i demokracisë dhe i tolerancës	Të gjitha komunitetet	- Promovimi i të drejtave të njeriut, i pjesëmarrjes dhe i gjithëpërfshirës së grave

KOMUNA E DRAGASHIT/DRAGAŠ

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI
Njësi rajonal i Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje	Drejtoria rajonale e Policisë së Kosovës në Prizren Fshati: Lubizhdë/Lubižda	dhunafamiljare_pz@hotmail.com	192 Ext 6028
Qendra për punë sociale	Rr. "Radesha"	qpssharr@gmail.com	029281227
ZKBGJ dhe NJKDNJ	Objekti i komunës, rr. "Sheshi i Dëshmorëve"	nuk është në dispozicion	029281543
Zyrtari për mbrojtjen e viktimave	Mbulohet nga zyra e Prizrenit: (në objektin e Prokurorisë Publike të Qarkut, hyrja II) , rr. "William Walker"	Vaau_advocates@yahoo.com	029241898 044310468

STREHIMORJA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI
Kryesisht mbulohet nga strehimorja në Prizren	qsgf_pz@hotmail.com	029225518

IAP	ADRESA	TELEFONI
Mbulohet nga zyra në terren e Prizrenit	Rr. "Remzi Ademi"	029222138

OJQ-të	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI	QËLLIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Inicijativa e grave	Sheshi i dëshmorëve, p.n.	nuk është në dispozicion	nuk është në dispozicion	Përkrahje grave në komunën e Dragashit/Dragaš	Gratë	- Promovimi i barazisë gjinore, fuqizimi i grave, edukimi shëndetësor i grave - Vetëdijesim për dhunën në familje

KOMUNA E FERIZAJIT/UROŠEVAC

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI
Njësi rajonal i Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje	Drejtoria rajonale e Policisë së Kosovës në Ferizaj/Uroševac, rr. "Driton Islami"	dhunafamiljare@hotmail.com	03850801194
Qendra për punë sociale	Rr. "Vëllezërit Gërvalla"	qpsferizaj@gmail.com	0290327525
ZKBGJ dhe NJKDNJ	Objekti i komunës, rr. "Dëshmoret e Kombit"	nuk është në dispozicion	0290320591
Zyrtari për mbrojtjen e viktimave	Rr. "Sejdi Sejdiu" (afër xhamisë dhe kishës)	vaau_advocates@yahoo.com	0290325602 044352937

STREHIMORJA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI
Kryesisht mbulohet nga strehimorja në Gjilan/Gnjilane	Liriagjilan10@hotmail.com	044125729 numri kujdestar për ndihmë 24 h: 0280325700

IAP	ADRESA	TELEFONI
Mbulohet nga zyra në terren e Gjilanit/Gnjilane	Objekti i II-të i komunës Rr. "Adem Jashari"	0280320843

GPK	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI	QËLLIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Komiteti për barazi gjinore	Objekti i komunës, rr. "Dëshmoret e Kombit"	nuk është në dispozicion	0290320591	- Ofrimi i një forumi diskutimesh për palët përkatëse të interesit për dhunën në baza gjinore	Gratë, vajzat e reja dhe fëmijët	- Aktivitete vetëdijesimi - Shkëmbim informatash

TASK FORCA	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI	QËLLIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Task forca për mbrojtjen e fëmijëve	(QPS), rr. "Vëllezërit Gërvalla"	qpsferizaj@gmail.com	0290327525	- Zhvillimi i një rrjeti sigurie për mbrojtjen e fëmijëve	Fëmijët	- Takime mujore ndër-institucionale me qëllim të përcjelljes së rasteve

OJQ-të	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI	QËLLIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
AJO	Shkolla "Jeronim De Rada" (në oborr të shkollës) Nuk ka emër ose numër të rrugës	nuk është në dispozicion	nuk është në dispozicion	- Promovimi i mirëqenies së grave dhe fëmijëve - Luftimi i dhunës në baza gjinore, në veçanti lidhur me viktimat e trafikimit me qenie njerëzore	Gratë, fëmijët dhe rinia	Emancipimi i grave, kujdesi shëndetësor dhe social, Arsimim, Vetëdijesim, Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe edukative

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS/KOSOVO POLJE

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI
Njësi rajonal i Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje	Drejtoria rajonale e Policisë së Kosovës në Prishtinë/Priştina Stacioni policor nr. 2, rr. "Mahalla e Muhaxhirëve"	nuk është në dispozicion	92 (fiks) 192 (mobil)
Qendra për punë sociale	Rr. "Nëna Terezë"	nuk është në dispozicion	038536462
ZKBGJ dhe NJKDNJ	Rr. "Nëna Terezë"	nuk është në dispozicion	038537537
Zyrtari për mbrojtjen e viktimave	Mbulohet nga ZMV për Prishtinë /Priştina: objekti i Gjykatës së Qarkut, kati IV, rr. "Ilir Konushevci"	vaau_advocates@yahoo.com	038246059 044278738

STREHIMORJA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI
Kryesisht mbulohet nga strehimorja në Prishtinë/Priştina	cpëcprishtina@yahoo.com	044508081 038545476

IAP	ADRESA	TELEFONI
Mbulohet nga zyra e Prishtinës/Priştina	Rr. "Enver Maloku", nr. 28	038501401 038545303

TASK FORCA	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI	QËLLIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Task forca për mbrojtjen e fëmijëve në Fushë Kosovë/Kosovo Polje	(QPS), rr. "Nëna Terezë"	nuk është në dispozicion	(QPS) 038536462	- Zhvillimi i një rrjeti sigurie për mbrojtjen e fëmijëve	- Fëmijët që janë viktimë e moskujdesit ose abuzimit - Fëmijët e shfrytëzuar ose të trafikuar - Delinkuentët - Të miturit që bien ndesh me ligjin	- Takime mujore ndër-institucionale me qëllim të përcjelljes së rasteve - Identifikimi i fëmijëve që lypin lëmshë dhe që shfrytëzohen përmes punës së detyruar - Avokim të autoritetet vendore me qëllim të prezantimit të punës së task forcës dhe lobimit për institucionalizimin e saj - Krijimi i mekanizmave adekuat të referimit për të përmirësuar efikasitetin e menaxhimit të rasteve

KOMUNA E GJAKOVËS/ ĐAKOVICA

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI
Njësi rajonal e Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje	Drejtoria rajonale e Policisë së Kosovës në Pejë/Peç, rr. "Mbretëresha Teutë"	nuk është në dispozicion	92 (fiks) 192 (mobil)
Qendra për punë sociale	Rr. "Hysni Zajmi"	nuk është në dispozicion	0390323510
ZKBGJ dhe NJKDNJ	Objekti i komunës, rr. "Nëna Terezë", nr. 469	nuk është në dispozicion	0390321100
Zyrtari për mbrojtjen e viktimave	Zyra e Prokurorit Publik, Gjakovë/Đakovica	vaau_advocates@yahoo.com	044418658

STREHIMORJA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI
Gjakovë/Đakovica	linjauaj@hotmail.com	0390330098

IAP	ADRESA	TELEFONI
Mbulohet nga zyra në terren e Pejës/Peç	Objekti i komunës, rr. "Mbretëresha Teutë", nr. 59	039432931

OJQ-të	ADRESA	POSTA ELEKTRONIKE	TELEFONI	QËLLIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
